



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, nenit 4 të Udhëzimit administrativ nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit publik si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM**  
**PËR THEMELIMIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT**

**Neni 1**

**Themelimi ,përbërja dhe mandati i Komitetit të Auditimit**

Me këtë Vendim, themelohet Komiteti i Auditimit në Komunën e Lipjanit (në vazhdim të tekstit Komiteti), në përbërje si vijon:

1. Fitim Sadiku, nga shoqëria civile, Kryesues,
2. Fatbardha Shurdhiqi, nëpunëse civile, anëtare,
3. Shkëlqim Bahtiri nga shoqëria civile, anëtar

Mandati i Komitetit është 3 (tre) vjeçar, me të drejtë riemërimi, por jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme

**Neni 2**

**Detyrat, përgjegjësitë dhe takimet e Komitetit**

1. Komiteti do ti kryej detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me dispozitat të Ligjit Nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe Udhëzimit administrativ nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit publik.
2. Takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër (4) herë në vit dhe ftohen nga Kryesuesi i Komitetit të Auditimit
3. Udhëheqësi i njësisë së auditimit të brendshëm merr pjesë në takimet e Komitetit të Auditimit me përjashtim kur Komiteti i Auditimit diskuton temat që ndërlidhen me performancën e Njësisë së auditimit të brendshëm të subjektit të sektorit publik.
- 4.Njësia e auditimit të brendshëm ofron shërbimet e sekretarisë për Komitetin e Auditimit
- 5.Pagesa e anëtarëve të Komitetit bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Njësia e Auditimit të brendshëm, Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit .

1Nr. 052-48065  
Lipjan, më 09.10 .2020

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

